



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 24

Tiranë – E martë, 16 shkurt 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 4/2021 datë 28.1.2021	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 34, datë 16.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 88/2019, ‘Për buxhetin e vitit 2020’, të ndryshuar”.....
	2707
Dekret i Presidentit nr. 11958, datë 10.2.2021	Për shpallje ligji.....
	2707
Ligj nr. 6/2021 datë 28.1.2021	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 36, datë 23.12.2020, “Për zgjatjen e afatit të vlefshmërisë së certifikatës së kontrollit teknik”.....
	2707
Dekret i Presidentit nr.11959, datë 10.2.2021	Për shpallje ligji.....
	2707
Ligj nr. 7/2021 datë 28.1.2021	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 37, datë 24.12.2020, “Për disa ndryshime në aktin normativ nr. 8, datë 7.12.2019, të Këshillit të Ministrave, ‘Për përdorimin e procedurës së përsheptuar, për subvencionimin e pagesës së qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019”.....
	2708
Dekret i Presidentit nr. 11960, datë 10.2.2021	Për shpallje ligji.....
	2708
Ligj nr. 9/2021 datë 28.1.2021	Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe organizatës së Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë (FAO), për krijimin e një përfaqësie të FAO-s në Republikën e Shqipërisë.....
	2708
Dekret i Presidentit nr. 11955, datë 9.2.2021	Për shpallje ligji.....
	2712

Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 12.2.2021	Për disa shtesa në ligjin nr. 105/2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar.....	2712
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1179, datë 24.12.2020	Për rregullat e përdorimit, administrimit dhe ruajtjes së bazës së të dhënave për pasuritë e paluajtshme dhe për miratimin e listës së institucioneve që kanë të drejtën e aksesit në sistemin elektronik të të dhënave.....	2713
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1181, datë 24.12.2020	Për miratimin e rregullave të krijimit, përdorimit, administrimit, ruajtjes dhe ndërveprimit të bazës së të dhënave të proceseve kalimtare të pronësisë.....	2717
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 85, datë 10.2.2021	Për një shtesë në vendimin nr. 597, datë 4.9.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”.....	2723
	Anekset që duhet t’i ishin bashkëlidhur vendimit nr. 1178, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e dokumentacionit dhe të rregullave të hollësishme të evidentimit të ndërtimeve pa leje”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 22, datë 11 shkurt 2021.....	2724

**LIGJ**
Nr. 4/2021

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT, NR. 34, DATË
16.12.2020, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR DISA NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 88/2019, ‘PËR
BUXHETIN E VITIT 2020’, TË
NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 78, 101 dhe 160 të
Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të
Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr.
34, datë 16.12.2020, i Këshillit të Ministrave, “Për
disa ndryshime në ligjin nr. 88/2019, ‘Për buxhetin
e vitit 2020’, të ndryshuar”.

Miraturar në datën 28.1.2021

**Shpallur me dekretin nr. 11958, datë 10.2.2021,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta.**

DEKRET
Nr. 11958, datë 10.2.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe të nenit
93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 4/2021, “Për miratimin e
aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 34, datë
16.12.2020, të Këshillit të Ministrave, ‘Për disa
ndryshime në ligjin nr. 88/2019, ‘Për buxhetin e
vitit 2020’, të ndryshuar”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

LIGJ
Nr. 6/2021

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT, NR. 36,
DATË 23.12.2020, “PËR ZGJATJEN E
AFATIT TË VLEFESHMËRISË SË
CERTIFIKATËS SË KONTROLLIT
TEKNIK”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të
Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të
Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr.
36, datë 23.12.2020, “Për zgjatjen e afatit të
vlefshmërisë së certifikatës së kontrollit teknik”.

Miraturar në datën 28.1.2021

**Shpallur me dekretin nr. 11959, datë 10.2.2021,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta.**

DEKRET
Nr. 11959, datë 10.2.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe të nenit
93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 6/2021, “Për miratimin e
aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 36, datë
23.12.2020, ‘Për zgjatjen e afatit të vlefshmërisë së
certifikatës së kontrollit teknik”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta



LIGJ
Nr. 7/2021

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT, NR. 37,
DATË 24.12.2020, “PËR DISA
NDRYSHIME NË AKTIN NORMATIV
NR. 8, DATË 7.12.2019, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, ‘PËR PËRDORIMIN
E PROCEDURËS SË PËRSHPEJTUAR,
PËR SUBVENCIONIMIN E PAGESËS
SË QIRASË SË BANESËS, PËR
FAMILJET E MBETURA TË PASTREHA,
SI PASOJË E FATKEQËSISË
NATYRORE, TËRMETIT TË DATËS
26.11.2019”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 37, “Për disa ndryshime në aktin normativ nr. 8, datë 7.12.2019, të Këshillit të Ministrave, ‘Për përdorimin e procedurës së përsheptuar, për subvencionimin e pagesës së qirasë së banesës, për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019”.

Miraturar në datën 28.1.2021

**Shpallur me dekretin nr. 11960, datë 10.2.2021,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta.**

DEKRET
Nr. 11960, datë 10.2.2021
PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe të nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 7/2021, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 37, datë 24.12.2020, ‘Për disa ndryshime në aktin normativ

nr. 8, datë 7.12.2019, të Këshillit të Ministrave, ‘Për përdorimin e procedurës së përsheptuar, për subvencionimin e pagesës së qirasë së banesës, për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**
Ilir Meta

LIGJ
Nr. 9/2021

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES,
NDËRMJET KËSHILLIT
TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE ORGANIZATËS
SË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR
USHQIMIN DHE BUJQËSINË (FAO),
PËR KRIJIMIN E NJË PËRFAQËSIE TË
FAO-s NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë (FAO), për krijimin e një përfaqësie të FAO-s në Republikën e Shqipërisë, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 28.1.2021

**Shpallur me dekretin nr. 11955, datë 9.2.2021
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta.**

**MARRËVESHJE**

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE ORGANIZATËS SË KOMBEVE TË
BASHKUARA PËR USHQIMIN DHE
BUJQËSINË (FAO) MBI KRIJIMIN E NJË
PËRFAQËSIE TË FAO-S NË REPUBLIKËN
E SHQIPËRISË

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë
dhe

Organizata e Kombeve të Bashkuara për
Ushqimin dhe Bujqësinë,

me dëshirën për të nënshkruar një marrëveshje për
krijimin e një përfaqësie të FAO-s në Republikën e
Shqipërisë, kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni I**Personaliteti juridik dhe liria e takimeve**

1. FAO ka personalitet juridik dhe kompetencën:

- a) të kontrakttojë;
- b) të blejë dhe të disponojë pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme;
- c) të ndërmarrë procedura ligjore.

2. Qeveria njeh të drejtën e FAO-s për të organizuar takime në Republikën e Shqipërisë. Në takimet e organizuara nga FAO, Qeveria duhet të marrë të gjitha masat për të garantuar që të mos ketë asnjë pengesë ndaj lirisë së plotë të diskutimit dhe të vendimit.

Neni II**Prania e FAO-s në Republikën e Shqipërisë**

1. Zëvendëspërfaqësuesi Rajonal i FAO-s për Evropën dhe Azinë Qendrore, me qendër në Budapest, Hungari, do të shërbejë si Përfaqësues i FAO-s në Republikën e Shqipërisë dhe FAO do të caktojë në zyrën e vet në Tiranë personel tjetër, siç mund të jetë e nevojshme për ta ndihmuar atë në kryerjen e funksioneve të veta, përfshirë një asistent të përfaqësisë së FAO-s. Ai/ajo do të vizitojë Republikën e Shqipërisë afërsisht katër herë në vit për të kontaktuar me autoritetet dhe për të mbikëqyrur aktivitetet e FAO-s.

2. Kurdoherë që caktohet një zëvendëspërfaqësues i ri Rajonal për Evropën dhe Azinë Qendrore, FAO duhet të paraqesë emrin e

tij/saj, jetëshkrimin dhe detajet e tjera përkatëse në Qeveri për informacion.

3. FAO do t'i sigurojë Qeverisë së Republikës së Shqipërisë informacionin e duhur për të gjithë stafin e të huajve që ajo propozon të caktohet në përfaqësimin e FAO-s. Përfaqësimi i FAO-s në Republikën e Shqipërisë do të ketë personel tjetër, të cilin FAO e konsideron të përshtatshëm për funksionim të duhur. FAO do të njoftojë Qeverinë, siç gjykohej e nevojshme, për emrat e personelit, anëtarët e familjes së tyre dhe ndryshimet në statusin e disa personave.

4. Qeveria do t'i japë falas FAO-s dhe FAO do të pranojë, që nga hyrja në fuqi dhe gjatë gjithë zgjatjes së kësaj marrëveshjeje, përdorimin dhe shfrytëzimin e ambienteve dhe pajisjeve të tjera të përshtatshme për punën e përfaqësuesve të FAO-s, siç tregohet në shtojcën I, e cila është pjesë integrale e kësaj marrëveshjeje.

5. Qeveria do të lehtësojë tranzitin dhe do të bëjë përjashtim nga detyrimet doganore dhe nga ndalimet dhe kufizimet në importet dhe eksportet në lidhje me artikujt ose çdo dërgesë tjetër të importuar nga FAO, për funksionimin e duhur të përfaqësimit të FAO-s. Në një frymë bashkëpunimi të ngushtë me FAO-n, Qeveria do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të lehtësuar hyrjen në territorin e Republikës së Shqipërisë, qëndrimin dhe largimin nga ky territor të të gjithë personelit të FAO-s, si dhe të personave të tjerë të ftuar nga përfaqësimi i FAO-s në Republikën e Shqipërisë për punë zyrtare, për sa kohë që udhëtimi kryhet në lidhje me aktivitetet e FAO-s.

6. Përfaqësuesi i FAO-s do të jetë përgjegjës për të gjitha aspektet e veprimtarisë së FAO-s në Republikën e Shqipërisë, brenda kufijve të autoritetit që i është deleguar atij/asaj dhe të sigurojë kontaktin me zyrat e tjera të FAO-s, përfshirë selinë dhe Zyrën Rajonale për Evropën dhe Azinë Qendrore.

7. Për kryerjen efektive të funksioneve të tij/saj, përfaqësuesi i FAO-s do të ketë qasje të drejtpërdrejtë, në përputhje me procedurat e vendosura të Qeverisë, në të gjitha nivelet e dhura të politikës dhe planifikimit të Qeverisë që merren drejtpërdrejt ose indirekt me sektorët e bujqësisë, peshkimit dhe pyjeve, si dhe të sektorëve të tjerë të ekonomisë kombëtare që lidhen me këto fusha.



Neni III Prona dhe pasuritë

1. Qeveria do të zbatojë për pronat, fondet dhe pasuritë e FAO-s, dispozitat e nenit III, të “Konventës mbi privilegjet dhe imunitetet e agjencive të specializuara”.

2. Të gjitha mallrat dhe artikujt e blerë ose të importuar në Republikën e Shqipërisë nga përfaqësia e FAO-s, nën përjashtimet e parashikuara në këtë paragraf, mund të hidhen në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me kushtet e rëna dakord me Qeverinë.

Neni IV Komunikimet

Qeveria duhet të zbatojë për FAO-n dispozitat e nenit IV, të “Konventës për privilegjet dhe imunitetet e agjencive të specializuara”, për sa i përket lehtësirave në lidhje me komunikimet.

Neni V Zyrtarët e FAO-s

1. Qeveria duhet të zbatojë për zyrtarët e FAO-s dispozitat e nenit VI, të “Konventës për privilegjet dhe imunitetet e agjencive të specializuara”. Për më tepër, zyrtarët ndërkombëtarë të rekrutuar nga FAO kanë të drejtën që të importojnë një automjet duke u përjashtuar nga detyrimet doganore dhe të akcizës, përfshirë TVSH-në, në përputhje me rregulloren ekzistuese të Republikës së Shqipërisë të zbatueshme për misionet diplomatike të të njëjtit rang.

2. Qeveria duhet pajisë zyrtarët e FAO-s me karta identiteti që vërtetojnë se ata gëzojnë të drejtën e privilegjeve, imuniteteve dhe përjashtimeve të parashikuara nga kjo marrëveshje në rastet kur ata do të jenë mbajtës të lejes së veçantë të kalimit të Kombeve të Bashkuara.

Neni VI Përfaqësuesi i FAO-s

Përveç privilegjeve dhe imuniteteve të përmendura në nenin V të kësaj marrëveshjeje, Qeveria bie dakord që t'i japë përfaqësuesit të FAO-s privilegje dhe imunitete jo më pak të favorshme sesa ato që u janë dhënë anëtarëve të

personelit diplomatik të misioneve diplomatike të të njëjtit rang, të akredituar në Republikën e Shqipërisë. Për këtë qëllim, emri i tij/saj duhet të përfshihet në listën diplomatike. Bashkëshorti/ja i tij/e saj dhe personat nën ngarkim duhet të gëzojnë privilegjet dhe imunitetet që i janë dhënë bashkëshortit/es dhe personave nën ngarkim të anëtarëve të personelit të misioneve diplomatike të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Neni VII Ekspertët në mision

Ekspertëve që kryejnë misione për FAO-n, përfshirë personat që kryejnë shërbime në emër të FAO-s, duhet t'u krijohen lehtësitë që janë të nevojshme për kryerjen e funksioneve të tyre në mënyrë të pavarur gjatë periudhës së misioneve të tyre, përfshirë kohën që ata kalojnë në udhëtimet që lidhen me misionin e tyre. Në veçanti, për ta duhet të zbatohen dispozitat e pikës 2, të shtojcës II, të “Konventës për privilegjet dhe imunitetet e agjencive të specializuara”.

Neni VIII Leja e veçantë e kalimit

Qeveria do të njohë lejet e veçanta të kalimit të Kombeve të Bashkuara, të lëshuara zyrtarëve të FAO-s, si një dokument të vlefshëm udhëtimi ekuivalent me një pasaportë. Kërkesat për viza nga mbajtësit e kësaj leje të veçantë të Kombeve të Bashkuara do të trajtohen sa më shpejt që të jetë e mundur.

Neni IX Dispozita të përgjithshme

1. Privilegjet, imunitetet, përjashtimet dhe lehtësitë e akorduara në këtë marrëveshje jepen në interes të FAO-s dhe jo për përfitime personale të personave në fjalë. Drejtori i Përgjithshëm ka për detyrë të heqë imunitetin e çdo personi që gëzon privilegje dhe imunitete sipas kësaj marrëveshjeje, në çdo rast kur, sipas mendimit të tij, një imunitet i tillë mund të hiqet pa cenuar interesat mbizotërues të FAO-s.

2. FAO do të bashkëpunojë në çdo kohë me Qeverinë për të lehtësuar administrimin e duhur të drejtësisë, për të siguruar respektimin e rregullave të



policisë dhe për të parandaluar shfaqjen e çdo abuzimi në lidhje me privilegjet, imunitetet dhe lehtësitë e dhëna sipas marrëveshjes.

3. Për të gjitha shërbimet e FAO-s, në bazë të kësaj marrëveshjeje, të cilat ofrohen për përfitimet e Republikës së Shqipërisë, Qeveria do të mbartë të gjitha rreziqet e operacioneve që vijnë nga kjo marrëveshje. Ai do të jetë përgjegjës për trajtimin e kërkesave të cilat mund të sillen nga palë të treta kundër FAO-s, zyrtarëve të tyre ose personave të tjerë që kryejnë shërbime për FAO-n, dhe do t'i mbajë ata të padëmshëm në lidhje me pretendimet ose detyrimet që rrjedhin nga operacionet sipas kësaj marrëveshjeje. Dispozita e mësipërme nuk do të zbatohet kur palët bien dakord që një kërkesë ose përgjegjësi të lindë nga neglizhenca e rëndë ose sjellja e gabuar e vullnetshme e individëve të lartpërmendur.

Neni X

Marrëveshjet plotësuese

Qeveria dhe FAO mund të lidhin marrëveshje të tilla shtesë, nëse mund të jenë të nevojshme, brenda fushës së kësaj marrëveshjeje.

Neni XI

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet FAO-s dhe Qeverisë në lidhje me interpretimin apo zbatimin e kësaj marrëveshjeje apo ndonjë marrëveshjeje plotësuese, ose për ndonjë çështje që ndikon në përfaqësinë e FAO-s apo në lidhje me marrëdhënien ndërmjet FAO-s dhe Qeverisë, e cila nuk zgjidhet me bisedime apo me ndonjë mënyrë tjetër që është rënë dakord, duhet të dërgohet për vendim të formës së prerë te një gjykatë e përbërë prej tre arbitrash: një të zgjidhet nga Drejtori i Përgjithshëm i FAO-s, një të zgjidhet nga Qeveria dhe i treti, i cili duhet të jetë Kryetari i Gjykatës duhet të zgjidhet nga dy arbitrat e parë. Nëse dy arbitrat e parë nuk bien dakord për të tretin, arbitri i tretë duhet të zgjidhet nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë.

Neni XII

Dispozitat përfundimtare

1. Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit nga pala shqiptare për përmbushjen e procedurave të nevojshme ligjore për hyrjen në fuqi të saj. Marrëveshja vazhdon të jetë në fuqi derisa të përfundojë sipas paragrafit 3, më poshtë.

2. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me marrëveshje me shkrim ndërmjet palëve të kësaj marrëveshjeje. Çdo çështje përkatëse për të cilën nuk ka ndonjë dispozitë në këtë marrëveshje duhet të vendoset nga palët. Secila palë duhet të tregojë konsideratë të plotë dhe dashamirësi ndaj çdo propozimi të bërë nga pala tjetër.

3. Kjo marrëveshje mund përfundohet nga secila palë me një njoftim me shkrim nga pala tjetër dhe duhet të përfundojë brenda gjashtëdhjetë ditëve pas marrjes së këtij njoftimi.

4. Detyrimet e marra përsipër nga Qeveria duhet të vazhdojnë edhe pas skadimit apo përfundimit kësaj marrëveshjeje, deri sa të jetë e nevojshme, për të lejuar tërheqjen e duhur të stafit, fondeve dhe pronës së FAO-s, sipas kësaj marrëveshjeje.

Në prani të palëve nënshkruese, përfaqësuesit e caktuar ligjërisht nga Organizata e Kombeve të Bashkuar për Ushqimin dhe Bujqësinë dhe nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, përkatësisht, në emër të palëve, kanë nënshkruar këtë marrëveshje në dy kopje, në Romë, Itali, në 1 dhjetor 2014.

PËR KËSHILLIN E
MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Shkëlqesisë së tij
Edmond Panariti
Ministër i Bujqësisë
Zhvillimit Rural dhe
Administrimit të
Ujërave

PËR ORGANIZATËN
E KOMBEVE TË
BASHKUARA TË
USHQIMIT DHE
BUJQËSISË

Jose Graziano da Silva
Drejtor i Përgjithshëm

**Aneksi I**

**KONTRIBUTI I QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË
PËRFAQËSIMIN E FAO-s**

I. Premisat e përfaqësimit të FAO-s dhe ambientet përkatëse

1. Selia e përfaqësimit të FAO-s sigurohet nga qeveria dhe do të jetë e vendosur në Ministrinë e Bujqësisë, në Tiranë, në adresën e mëposhtme: [...]

2. Për të siguruar funksionimin e duhur të përfaqësimit të FAO-s, Qeveria merr përsipër t'i sigurojë zyrës, për përdorimin e saj ekskluziv, ambiente të mobiluara në mënyrë të përshtatshme, të miratuara për nevojat e një zyre për 4–5 anëtarë të stafit. Kërkesat konkrete teknike për ambientet, pajisjet dhe mobilet do të përcaktohen reciprokisht gjatë konsultimeve dypalëshe. Qeveria do të mbulojë koston e të gjitha ndërmarrjeve (ujë, gaz, energji elektrike etj.).

3. Këto ambiente do të vihen në dispozicion të FAO-s jo më vonë se 3 muaj pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje.

4. Qeveria do të sigurojë mbulim të sigurisë dhe të mbrojtjes, dhe do të bëjë aranzhime të tilla që mund të jenë të nevojshme në lidhje me këtë, në mënyrë që zyra të jetë plotësisht në përputhje me Standardet e Sigurisë Operative të Kombeve të Bashkuara (MOSS), të cilat do të komunikohen nga FAO tek autoritetet e duhura kombëtare.

II. Personeli

1. Qeveria do të sigurojë personelin e mëposhtëm në përfaqësimin e FAO-s dhe do të vazhdojë të jetë përgjegjëse për pagat e tyre, kostot sociale, mjekësore dhe kostot e tjera të ngjashme:

- Sekretar;
- Nëpunës administrativ;
- Shofer.

2. FAO do t'i sigurojë Qeverisë përshkrimet e punës për pozicionet e mësipërme. Qeveria do të propozojë, mbi atë bazë, tre kandidatë, nga të cilët një do të zgjidhet nga FAO, me kusht që ai/ajo të plotësojë kualifikimet thelbësore, siç vlerësohet nga FAO. Në rastin e sekretarëve, FAO do të organizojë teste të tilla siç mund të kërkojnë.

3. Staf i kombëtar i siguruar nga Qeveria, nën këtë shtojcë, do të gëzojë imunitet të procesit ligjor në lidhje me fjalët e thëna ose të shkruara, ose veprimet në kryerjen e funksioneve zyrtare sipas

marrëveshjes, imuniteti i tillë të vazhdojë pavarësisht nëse personat në fjalë nuk i shërbejnë më organizatës. Për më tepër, stafit kombëtar do t'i akordohet paprekshmëria e dokumenteve dhe dokumenteve të tyre në lidhje me punën në të cilën janë të angazhuar për organizatën.

DEKRET

Nr. 11955, datë 9.2.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe të nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 9/2021, “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësisë (FAO), për krijimin e një përfaqësie të FAO-s në Republikën e Shqipërisë”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

AKT NORMATIV

Nr. 5, datë 12.2.2021

**PËR DISA SHTESA NË LIGJIN
NR. 105/2014, “PËR BARNAT DHE
SHËRBIMIN FARMACEUTIK”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr. 105/2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në nenin 3 bëhen këto shtesa:

a) Pas pikës 4 shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:



“4/1 “Autorizim i kushtëzuar i tregtimit” është dokumenti i lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore gjatë periudhave të epidemive ose fatkeqësive natyrore, sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj.”.

b) Pas pikës 19 shtohet pika 19/1, me këtë përmbajtje:

“19/1 “Bar jetim” është bari i cili ka për qëllim diagnostikimin, parandalimin ose trajtimin e një gjendjeje kërcënuese për jetën ose dobësuese, në mënyrë kronike, që prek jo më shumë se 5 në 10 000 njerëz.”.

Neni 2

Në shkronjën “b”, të pikës 2, të nenit 12, pas fjalës “Australi” shtohen fjalët “Mbretëri e Bashkuar”.

Neni 3

Pas nenit 14 shtohet neni 14/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 14/1

Autorizimi i kushtëzuar i tregtimit

1. Agjencia lëshon një autorizim tregtimi të kushtëzuar gjatë periudhave të epidemive ose fatkeqësive natyrore vetëm pasi bari të jetë pajisur me autorizim të kushtëzuar tregtimi nga Agjencia Evropiane e Vlerësimit të Barnave (EMA) ose Institucioni i Administrimit për Ushqimin dhe Barnat (FDA) i Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

2. Autorizimi i kushtëzuar i tregtimit, i përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, lëshohet, gjithashtu, për rastet, si më poshtë vijon:

a) barnat të cilat synojnë trajtimin, parandalimin ose diagnostikimin mjekësor të sëmundjeve të cilat dobësojnë shëndetin ose të sëmundjeve të rrezikshme për jetën;

b) barnat të cilat përdoren në situata emergjente, si përgjigje ndaj kërcënimeve të shëndetit publik të njohura nga Organizata Botërore e Shëndetësisë;

c) barnat e përcaktuara si barna jetime.

3. Autorizimi i kushtëzuar i tregtimit është i vlefshëm për 1 (një) vit dhe lëshohet nga Agjencia brenda 20 (njëzet) ditëve pune nga aplikimi, me përjashtim të vaksinave anticovid-19 për të cilat autorizimi lëshohet brenda 5 (pesë) ditëve pune.

4. Rregullorja për dhënien e autorizimit të kushtëzuar të tregtimit miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 4

Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 1179, datë 24.12.2020

PËR RREGULLAT E PËRDORIMIT, ADMINISTRIMIT DHE RUAJTJES SË BAZËS SË TË DHËNAVE PËR PASURITË E PALUAJTSHME DHE PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INSTITUCIONEVE QË KANË TË DREJTËN E AKSESIT NË SISTEMIN ELEKTRONIK TË TË DHËNAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, pika 6, e 28, pikat 6 e 8, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka për qëllim:

a) përcaktimin e mënyrës së përdorimit, administrimit dhe ruajtjes së të dhënave kadastrale të pasurive të paluajtshme (kadastrës në format digjital dhe/ose të çdo forme tjetër të administruar nga ASHK-ja);

b) përcaktimin e institucioneve që kanë të drejtën e aksesit në kadastrën digjitale dhe të kriterëve që duhet të plotësojnë personat juridikë/fizikë, vendas apo të huaj, që kanë të drejtën e marrjes së kodit hyrës;

c) përcaktimin e rregullave për konsultimin e informacionit dhe nxjerrjen e ekstrakteve në mënyrë të drejtpërdrejtë nga kadastra digjitale.

2. Në këtë vendim termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:



a) **“Baza shtetërore e të dhënave kadastrale – ALBSCAD”**, grumbullimi i organizuar i informacionit kadastral, si dhe i të dhënave që do të krijohen gjatë zbatimit të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, i ruajtur në formë elektronike, ku përpunimi dhe përditësimi i tij kryhen nëpërmjet një sistemi kompjuterik, si pjesë e plotësimit të detyrimeve ligjore të ASHK-së;

b) **“Ekstrakt nga baza e të dhënave kadastrale”**, dokumenti përmbledhës i të dhënave që merret nga përdoruesi i ALBSCAD-it;

c) **“Institucioni administrues”**, institucioni përgjegjës për administrimin e bazës së të dhënave shtetërore, në përputhje me aktin e krijimit;

ç) **“Kod hyrës”**, tërësia e kodit të autorizimit të përdorimit të sistemit, pra, të dhënat personale të përdoruesit dhe fjalëkalimi;

d) **“Të dhëna parësore dhe dytësore”**, të dhënat që administrohen nga ASHK-ja, sipas kuptimit të dhënë në nenin 7, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”.

3. Institucioni administrues i bazës shtetërore të të dhënave kadastrale është Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

4. Baza shtetërore e të dhënave kadastrale ndërvepron me bazën e të dhënave shtetërore të institucioneve të tjera, duke përdorur si të dhëna dytësore të dhënat parësore të tyre.

5. Mënyra e plotësimit dhe e përpunimit të të dhënave, shpërndarja e ekstrakteve nga ALBSCAD-i, e drejta e përdorimit dhe e ndërveprimit me bazat shtetërore të të dhënave të institucioneve të tjera bëhet duke garantuar sigurinë e sistemit, standardet dhe parimet për mbrojtjen e të dhënave personale, nëpërmjet disa niveleve të sigurisë. Rregullorja e funksionimit dhe e garantimit të sigurisë së përdorimit të ALBSCAD-it, sipas kësaj pike, miratohet nga Këshilli Drejtues i ASHK-së, në përputhje me përcaktimet e shkronjës “c”, të pikës 4, të nenit 8, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”.

6. Në çdo rast, e drejta e përdorimit të bazës shtetërore të të dhënave kadastrale ALBSCAD jepet e ushtrohet në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për të drejtën e informimit, për dokumentin elektronik, si dhe për mbrojtjen e të dhënave personale.

II. PËRMBAJTJA, ADMINISTRIMI DHE RUAJTJA E TË DHËNAVE KADASTRALE

7. Në sistemin e të dhënave kadastrale administrohen të dhënat e mëposhtme:

a) Të dhënat për pasuritë e paluajtshme, që përbëhen nga:

i. skeda digjitale për çdo pasuri (të dhënat e kartelës së pasurisë së paluajtshme);

ii. kufijtë, përmasat, pozicioni gjeografik i pasurisë (harta kadastrale);

iii. dokumentacioni ligjor për të drejtat mbi çdo pasuri;

iv. të dhëna të tjera në përmbajtje të kartelës së pasurisë së paluajtshme;

b) të dhënat që krijohen nga zbatimi i ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”;

c) dokumentacioni i krijuar gjatë regjistrimit fillestar dhe përmirësimit/përditësimit të zonave kadastrale;

ç) elementet e sigurisë (kontrolli i hyrjes, autentifikimi, enkriptimi, kontrollet e integritetit, *backup*-et etj.);

d) dokumentet ku evidentohet mënyra e ndërveprimit me bazat e të dhënave të institucioneve të tjera;

dh) dokumentet dhe informacioni për proceset e punës;

e) materialet për instruktim në ndihmë të përdoruesve të sistemit;

ë) ndërfaqe e bazuar në teknologjinë portal, si sisteme apo module;

f) funksionet e kërkimit mbi raportet statistikore;

g) raportet statistikore për kërkesat e qytetarëve, noterëve, institucioneve, për llojin e pasurive të paluajtshme, llojin e pronarëve dhe elemente të lidhura me to, raporte financiare e raporte për proceset e punës së ASHK-së etj.

8. Të dhënat parësore të ALBSCAD-it janë:

a) dokumentacioni tekniko-ligjor i pasurisë së paluajtshme dhe dokumentacioni që administrohet në kuadër të proceseve kalimtare të pronësisë, i cili merret si drejtpërdrejt nga sistemi me aplikimin për shërbim nga platformat digjitale, ashtu edhe në format shkresor;

b) skedat digjitale të pasurive të paluajtshme;

c) hartat kadastrale të pasurive të paluajtshme;

ç) aktet administrative (urdhra, vendime etj.) dhe aktet kadastrale të krijuara nga veprimtaria



administrative e ASHK-së mbi pasuritë e paluajtshme.

9. Të dhënat dytësore të ALBSCAD-it janë:

a) të dhënat identifikuese për palët, subjektet dhe të tretët;

b) të dhënat nga ndërveprimi me sistemet që administrohen nga institucione të tjera.

10. Përdoruesit e bazës shtetërore të të dhënave kadastrale janë të përcaktuara në këto nivele:

a) Administratori i sistemit, i cili administron bazën e të dhënave, në përputhje me aktin e krijimit;

b) Audituesi, i cili mbikëqyr të dhënat kadastrale;

c) Redaktuesi, i cili plotëson të dhënat kadastrale;

ç) Lexuesi, i cili konsulton të dhënat.

Për nivelet e përdoruesve të përcaktuar nga shkronja “b” deri në “ç”, të kësaj pike, funksionet dhe të drejtat janë në përputhje me pozicionin e punës dhe rregulloren e brendshme të funksionimit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

III. KRITERET DHE RREGULLAT PËR PAJISJE ME KOD HYRJEJE DHE SUBJEKTET QË KANË AKSES NË ALBSCAD

11. Institucionet shtetërore që ushtrojnë ndjekjen penale dhe agjencitë ligjzbatuese kanë akses të drejtpërdrejtë si përdorues në bazën shtetërore të të dhënave kadastrale, ALBSCAD. Lista e institucioneve është sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

12. E drejta e hyrjes në ALBSCAD mundësohet me paraqitjen e kërkesës nga institucioni përkatës dhe, brenda 2 (dy) ditëve nga paraqitja e saj, Drejtoria e Përgjithshme e ASHK-së pajis institucionin me kodin hyrës.

13. Me pajisjen me kodin hyrës, institucionet sipas aneksit 1, të këtij vendimi, kanë drejtë të konsultojnë të dhënat e ALBSCAD-it dhe të printojnë ekstrakte. Për noterët publikë, e drejta e leximit dhe e printimit të ekstrakteve që tregojnë gjendjen juridike të pasurive të paluajtshme bëhet vetëm pasi të jetë marrë autorizimi me shkrim nga pala e interesuar, sipas përcaktimeve të nenit 126, të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”.

14. ALBSCAD-i aksesohet vetëm nga persona të autorizuar të institucionit përkatës dhe vetëm

nga sistemet e administruara e të miratuara nga ASHK-ja. Të dhënat e personit të autorizuar i njoftohen Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për të mundësuar pajisjen me kodin e hyrjes dhe për të vënë në dispozicion kredencialet e përdoruesit.

15. Në asnjë rast kodin hyrës nuk mund t’u bëhet i ditur personave të tretë, të ndryshëm nga personi i autorizuar, pa njoftuar më parë ASHK-në, e cila ka për detyrë të verifikojë kriteret. Ndryshimi i personit të autorizuar nga institucioni përkatës bëhet sipas pikës 12, të këtij vendimi.

16. Institucionet që përdorin ALBSCAD-in kanë këto detyrime:

a) të përcaktojnë personat e autorizuar, që do të kenë të drejtën e përdorimit të sistemit për bazën digjitale të të dhënave kadastrale dhe t’ia njoftojnë atë ASHK-së;

b) të përdorin bazën digjitale të të dhënave kadastrale vetëm për qëllime të përmbushjes së detyrave funksionale, duke zbatuar legjislacionin në fuqi.

17. Shërbimet kadastrale për subjektet e interesuara (personat juridikë/fizikë, vendas apo të huaj), duke përfshirë edhe institucionet publike, ofrohen pas kërkesës për shërbime kadastrale në rrugë digjitale *online*, nëpërmjet platformës *e-Albania*, duke iu nënshtruar procedurave të parashikuara në vendimin nr. 389, datë 13.5.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale”.

18. Personat juridikë/fizikë, vendas apo të huaj, që kanë të drejtën për të pasur akses në portalin qeveritar *e-Albania*, mund të marrin dokumente kadastrale elektronike në mënyrë të drejtpërdrejtë, pasi kanë marrë pëlqimin e subjekteve, që figurojnë të regjistruar si pronarë të pasurisë së paluajtshme.

19. ASHK-ja garanton pasurimin me të dhëna të bazës shtetërore të të dhënave kadastrale, si dhe funksionimin normal, pa ndërprerje, të sistemeve të cilat bëjnë të mundur përdorimin e ALBSCAD-it.

20. Institucionet, që kanë të drejtën e përdorimit të ALBSCAD-it, paraqesin kërkesën për pajisje me kod hyrës sipas aneksit 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

21. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 8 (tetë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, duhet të mundësojë të drejtën e institucioneve për



marrijen e ekstrakteve nga baza shtetërore e të dhënave kadastrale.

22. Deri në përfundimin e procesit të integritetit të bazave të të dhënave të administruara nga ish-ZRPP-ja, ish-ALUIZNI dhe ish-AITPP-ja, komponentët e *software*-it dhe *hardware*-it do të jenë sipas vendimit nr. 375, datë 6.6.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, regjistrimin, mënyrën e funksionimit, të administrimit e të ndëreveprimit dhe për sigurinë e sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ALBSReP)”, dhe bazat aktuale të të dhënave do të funksionojnë të ndara.

23. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 375, datë 6.6.2012, “Për krijimin, regjistrimin, mënyrën e funksionimit, të administrimit e të ndëreveprimit dhe për sigurinë e sistemit të regjistrimit të pasurive

të paluajtshme (ALBSReP)”, (përveç anekseve 1 dhe 2); nr. 390, datë 6.6.2012, “Për përcaktimin e subjekteve që kanë të drejtën e aksesit në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme (ALBSReP)”; dhe nr. 496, datë 1.8.2012, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ushtrimit të së drejtës së aksesit për personat juridikë/fizikë, vendas apo të huaj, në sistemin elektronik të pasurive të paluajtshme”, shfuqizohen.

24. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Aneks 1

LISTA E INSTITUCIONEVE QË KANË TË DREJTËN E PËRDORIMIT TË SISTEMIT TË TË DHËNAVE KADASTRALE

1. Ministrinë
2. Bashkitë
3. Gjykatat e çdo niveli
4. Prokuroritë e çdo niveli
5. Policia e Shtetit
6. Organet që ushtrojnë kontrollin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve
7. Organet që ushtrojnë kontrollin kalimtar të Policisë së Shtetit
8. Organet e gjyqësorit
9. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave
10. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave
11. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara
12. Avokatura e Shtetit
13. Agjencia e Zhvillimit të Territorit
14. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
15. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
16. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
17. Qendra Kombëtare e Biznesit
18. Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG)
19. Drejtoria e Përgjithshme e Përmbaruesve Gjyqësorë Shtetërorë
20. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA)
21. Agjencia Kombëtare e Mjedisit
22. Agjencia e Trajtimit të Kredive
23. Noterët
24. Avokati i Popullit
25. Agjencia Shtetërore e Shpronësimit
26. Agjencia e Trajtimit të Pronave
27. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore
28. Agjencia Kombëtare e Bregdetit
29. Autoriteti Rrugor Shqiptar
30. Shërbimi Social Shtetëror



31. Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike
32. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
33. Ujësjellës-Kanalizime sh.a.
34. Enti Kombëtar i Banesave
35. Administratori i Shoqërive Huamarrëse
36. Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore
37. Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore
38. Agjencia Kombëtare e Pyjeve
39. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura

Aneks 2

FORMULAR KËRKESE PËR PAJISJE ME KOD HYRËS NË SISTEMIN E TË DHËNAVE KADASTRALE

Emri i përdoruesit:
Mbiemri i përdoruesit:
Dhoma e përdoruesit:
Adresa e përdoruesit:
Email-i i përdoruesit:
NID/NTUIS:
Telefon zyre:
Telefon celular:
UserName:

Përdoruesi/Administratori

VENDIM

Nr. 1181, datë 24.12.2020

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË KRIJIMIT, PËRDORIMIT, ADMINISTRIMIT, RUAJTJES DHE NDËRVEPRIMIT TË BAZËS SË TË DHËNAVE TË PROCESIVE KALIMTARE TË PRONËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, e 75, pika 2, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka për objekt përcaktimin e rregullave për krijimin, përdorimin, administrimin dhe ruajtjen e bazës së të dhënave të proceseve

kalimtare të pronësisë, sipas ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe për ndërvëprimin e saj me bazat e tjera të të dhënave shtetërore.

2. Baza e të dhënave të proceseve kalimtare është pjesë e bazës shtetërore të të dhënave kadastrale, të parashikuara në ligjin nr. 111/2018, “Për kadastrën”, dhe ka në përbërje të saj edhe të dhënat për ndërtimet pa leje.

3. Institucioni administrues i bazës së të dhënave të proceseve kalimtare është Agjencia Shtetërore e Kadastrës, këtu e në vijim ASHK-ja.

4. Baza e të dhënave shtetërore të proceseve kalimtare të pronësisë përmban të dhënat e:

a) akteve të marrjes së tokës në pronësi, të regjistruara;

b) kalimit në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore në përdorim;

c) legalizimit të ndërtimeve pa leje;

ç) miratimit të dokumentit të pronësisë për objektet, trojet funksionale, si dhe oborret në përdorim;

d) përditësimit të listave të pronave shtetërore;



dh) kalimit të pronësisë së truallit në zonat e stimuluar;

e) privatizimit të truallit shtetëror në përdorim.

5. Të dhënat që popullojnë bazën e të dhënave të proceseve kalimtare përftohen nga aplikimet ose kërkesat e subjekteve, aktet dhe veprimet e tjera administrative që kryejnë strukturat e ASHK-së gjatë zbatimit të procedurave, sipas ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

6. Dhënës të informacionit janë aplikuesit-subjektet, në favor të të cilëve kryhen proceset kalimtare të pronësisë, institucionet publike, qendrore e vendore, dhe vetë punonjësit e strukturat e ASHK-së për të dhënat të cilat mbledhen dhe administrohen prej tyre.

II. TË DHËNAT PARËSORE DHE DYTËSORE

7. Të dhëna parësore dhe dytësore të bazës së të dhënave, sipas secilit proces, janë si më poshtë vijon:

a) Të dhënat parësore të regjistrimit të AMTP-ve, ku përfshihen:

i. numri dhe data e AMTP-së;

ii. lloji i pasurisë dhe sipërfaqja e ngastrave ose parcelave, sipas AMTP-së;

iii. emri i fshatit ose kooperativës ose ndërmarrjes dhe vendndodhja e secilës ngastër ose parcelë, sipas AMTP-së;

iv. zona kadastrale, numri i pasurisë, pozicioni gjeografik dhe sipërfaqja e ngastrave ose parcelave, sipas regjistrimit të pasurive të paluajtshme;

v. pozicioni gjeografik dhe sipërfaqja e ngastrave ose parcelave pas evidentimit dhe saktësimit nga ASHK-ja;

vi. lloji i pasurisë së ngastrave ose parcelave sipas regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe pas evidentimit e saktësimit nga ASHK-ja;

vii. kodi unik i kartelës së pasurisë;

viii. vendimarrja përfundimtare administrative e ASHK-së mbi AMTP-në (regjistrimi, refuzimi i regjistrimit);

ix. sipërfaqja shtesë ose pronë shërbyese që kalohet në pronësi (nëse është rasti);

x. shkaku i refuzimit të regjistrimit (nëse është rasti);

xi. kërkesa për ngritjen e padisë drejtuar Avokaturës së Shtetit (nëse është rasti);

xii. vendimi i prefektit (ish-KV-së) për shfuqizimin, korrigjimin, saktësimin e AMTP-së (nëse ka të tillë);

xiii. heqja dorë ose jo nga padia e ngritur më parë prej prefektit (nëse është rasti).

b) Të dhënat parësore të kalimit në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore, që janë:

i. kërkesa e subjektit kërkuar;

ii. lloji i pasurisë dhe sipërfaqja e ngastrave ose parcelave, sipas kërkesës;

iii. fshati ose kooperativa ose ndërmarrja dhe vendndodhja e secilës ngastër ose parcelë, sipas kërkesës;

iv. pozicioni gjeografik, sipërfaqja dhe lloji i pasurisë së ngastrave ose parcelave, sipas regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe pas evidentimit ose saktësimit nga ASHK-ja;

v. plotësimi ose jo i kushteve të nenit 12, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore;

vi. vendimi i këshillit bashkiak për njohjen si përdorues faktik të tokës bujqësore (nëse është rasti);

vii. akti individual i kalimit të pronësisë (nëse është rasti);

viii. zona kadastrale dhe numri i pasurisë së ngastrave ose parcelave, sipas regjistrimit të pasurive të paluajtshme;

ix. kodi unik i kartelës së pasurisë;

x. sipërfaqja shtesë ose pronë shërbyese që kalohet në pronësi (nëse është rasti).

c) Të dhënat parësore për ndërtimet pa leje, që janë:

i. numri, data dhe kodi unik (INDEX) i aplikimit;

ii. vendndodhja (adresa) e ndërtimit pa leje, sipas aplikimit;

iii. lloji, funksioni i ndërtimit pa leje dhe prezenca ose jo e objektit ndihmës, sipas evidentimit në terren;

iv. sipërfaqja e ndërtimit dhe e parcelës, sipas evidentimit në terren;

v. zona kadastrale, numri i pasurive dhe kodi unik i kartelave të pasurive të paluajtshme ku shtrihet ndërtimi ose parcela, (para legalizimit), sipas regjistrimit të pasurive të paluajtshme;

vi. koordinatat e ndërtimit pa leje, sipas evidentimit në terren;



vii. gjendja juridike e pronësisë së pasurive, ku shtrihet parcela ndërtimore, sipas regjistrit të pasurive të paluajtshme, para legalizimit;

viii. të dhënat e aktit të kalimit ose njohjes të së drejtës së legalizimit në favor të të tretit, nëse ka të tillë;

ix. numri dhe data e deklaratës për zgjedhjen e ndërtimit, nëse është rasti;

x. genplani dhe planimetritë;

xi. numri dhe data e aktit të evidentimit në terren;

xii. urdhri i përfshirjes ose mospërfshirjes në fushën e zbatimit të ligjit;

xiii. vendimi për legalizim ose moslegalizim dhe shkaku i moslegalizimit (nëse është rasti);

xiv. aktekspertiza për qëndrueshmërinë konstruktive të objektit për ndërtimet mbi 4 kate dhe për shtesën në ndërtim të regjistruar dhe për objektet me shkelje të lejes së ndërtimit;

xv. dokumenti i fitimit të pronësisë mbi truallin, i paregjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, në rastet e nenit 25, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”;

xvi. numri, data, kohëzgjatja dhe shkaku, sipas aktit të pezullimit (nëse është rasti);

xvii. të dhënat e kalimit të pronësisë së parcelës, kur ka vendim të miratuar të Këshillit të Ministrave;

xviii. të dhënat e aktit ose vendimit të mëparshëm të kualifikimit, të miratuar para hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave, në zbatim të nenit 18, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”;

xix. vlera e detyrimit financiar për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore dhe shlyerja e tij;

xx. të dhënat e vendimit të Këshillit të Ministrave për kompensimin e pronarëve joposedues;

xxi. të dhënat e tjera të aplikimit, sipas formatit ose modelit të legjislacionit të kohës.

ç) Të dhënat parësore për objektet pa titull, trojet funksionale, që janë:

i. numri, data dhe kodi unik (INDEX) i aplikimit;

ii. vendndodhja ose adresa e objektit, sipas aplikimit;

iii. funksioni dhe sipërfaqja e objektit pa titull, sipas evidentimit në terren;

iv. funksioni i objektit pa titull para datës 10.8.1991 (nëse është rasti);

v. sipërfaqja e truallit funksional, sipas evidentimit në terren;

vi. koordinatat e objektit pa titull, sipas evidentimit në terren;

vii. zona kadastrale, numri i pasurive dhe kodi unik i kartelave, sipas regjistrit të pasurive të paluajtshme;

viii. gjendja juridike e pronësisë së pasurive ku shtrihet parcela ndërtimore, sipas regjistrit të pasurive të paluajtshme, para miratimit të dokumentit të pronësisë;

ix. genplani dhe planimetritë;

x. data e njoftimit publik;

xi. vendimi përfundimtar për pranim ose rrëzim të kërkesës, si dhe shkaku i rrëzimit të kërkesës (nëse është rasti);

xii. të dhënat e aplikimit për legalizim, nëse është deklaruar më parë edhe si ndërtim pa leje;

xiii. aktekspertiza ose dokumentacioni i dorëzuar nga aplikuesi, që provon vjetërsinë e objektit para datës 10.8.1991 (nëse është rasti);

xiv. numri, data, kohëzgjatja dhe shkaku, sipas aktit të pezullimit (nëse është rasti);

xv. vlera e detyrimit financiar për kalimin e pronësisë së truallit funksional dhe shlyerja e tij;

xvi. të dhënat e vendimit të Këshillit të Ministrave për kompensimin e pronarëve joposedues, nëse është rasti;

xvii. të dhënat e tjera të aplikimit, sipas formatit ose modelit të legjislacionit të kohës.

d) Të dhënat parësore për oborret në përdorim, që janë:

i. numri, data dhe kodi unik (INDEX) i aplikimit;

ii. vendndodhja ose adresa e pasurisë, sipas aplikimit;

iii. funksioni dhe sipërfaqja e objektit që i bashkëlidhet oborrit në përdorim, sipas evidentimit në terren;

iv. funksioni i objektit para datës 10.8.1991 (nëse është rasti);

v. koordinatat e oborrit në përdorim, sipas evidentimit në terren;

vi. zona kadastrale, numri i pasurive dhe kodi unik i kartelave të pasurive, ku shtrihet oborri në përdorim, sipas regjistrit të pasurive të paluajtshme;

vii. gjendja juridike e pronësisë së pasurive ku shtrihet oborri në përdorim, sipas regjistrit të



pasurive të paluajtshme, para miratimit të dokumentit të pronësisë;

viii. genplani;

ix. vendimi përfundimtar për pranim ose rrëzim të kërkesës dhe shkaku i rrëzimit të kërkesës (nëse është rasti);

x. aktekspektiza ose dokumentacioni i dorëzuar nga aplikuesi, që provon vjetërsinë e objektit para datës 10.8.1991 (nëse është rasti);

xi. numri, data, kohëzgjatja dhe shkaku, sipas aktit të pezullimit (nëse është rasti);

xii. vlera e detyrimit financiar për kalimin e pronësisë së oborrit në përdorim (nëse është rasti) dhe shlyerja e tij;

xiii. të dhënat e vendimit të Këshillit të Ministrave për kompensimin e pronarëve joposedues, nëse është rasti;

xiv. të dhënat e tjera të aplikimit, sipas formatit ose modelit të legjislacionit të kohës.

dh) Të dhënat parësore të përditësimit të listave të pronave shtetërore, që janë:

i. vendimi i Këshillit të Ministrave të mëparshëm që ka miratuar listën;

ii. institucioni qendror që ka përgjegjësinë e administrimit ose njësia e vetëqeverisjes vendore që i është transferuar prona;

iii. tagri i institucionit qendror ose NJVV-së mbi pronën (administrimi, pronësia ose përdorimi);

iv. sipërfaqja e pronës sipas listës;

v. zona kadastrale, numri kadastral dhe kodi unik i kartelave të pasurive, ku shtrihet prona sipas listës së pronave shtetërore;

vi. gjendja juridike e pronësisë së pasurive ku shtrihet prona, sipas listës së pronave shtetërore, para përditësimit të saj;

vii. sipërfaqja e pronës pas përditësimit;

viii. koordinatat e pronës, sipas evidentimit në terren, pas përditësimit;

ix. numri i pasurisë dhe kodi unik i kartelës së pronës shtetërore, pas përditësimit.

e) Të dhënat parësore të trojeve në zonat e stimuluar, që janë:

i. numri, data e aplikimit dhe kodi unik (INDEX) i aplikimit dhe cilësia e aplikuesit, si person i stimuluar apo subjekt i interesuar;

ii. vendndodhja ose adresa e pasurisë, sipas aplikimit;

iii. funksioni dhe sipërfaqja e njësisë ndërtimore, sipas evidentimit në terren;

iv. sipërfaqja e truallit të njësisë ndërtimore, sipas evidentimit në terren;

v. data e planit të rilevimit;

vi. koordinatat e pasurisë, sipas evidentimit në terren;

vii. zona kadastrale, numri kadastral dhe kodi unik i kartelave të pasurive, ku shtrihet trualli, sipas regjistrimit të pasurive të paluajtshme;

viii. gjendja juridike e pronësisë së pasurive ku shtrihet oborri në përdorim, sipas regjistrimit të pasurive të paluajtshme, para miratimit të dokumentit të pronësisë;

xi. gjendja juridike e njësisë ndërtimore, e regjistruar ose jo në favor të aplikuesit;

x. vendimi përfundimtar për kalimin e pronësisë;

xi. pjesa e bashkëpronësisë në truallin e njësisë ndërtimore (nëse është rasti) dhe në truallin e lirë;

xii. numri, data, kohëzgjatja dhe shkaku, sipas aktit të pezullimit (nëse është rasti);

xiii. vlera e detyrimit financiar për kalimin e pronësisë së truallit dhe shlyerja e tij;

xiv. akti për kalimin e njësisë ndërtimore në favor të shtetit (nëse është rasti);

xv. kërkesa për dorëzimin vullnetar të njësisë ndërtimore (nëse është rasti);

xvi. kërkesa për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit;

xvii. urdhri i ekzekutimit;

xviii. procesverbali i dorëzimit të njësisë ndërtimore;

xix. të dhënat e vendimit të Këshillit të Ministrave për kompensimin e pronarëve joposedues, nëse është rasti;

xx. të dhënat e tjera të aplikimit, sipas formatit ose modelit të legjislacionit të kohës;

xxi. marrëveshja e qirasë dhe zhvillimit, e lidhur mes personit të stimuluar dhe autoritetit shtetëror kompetent, nëse ka të tillë, së bashku me dokumentacionin tjetër përbërës të praktikës, sipas legjislacionit për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë.

ë) Të dhënat parësore për trojet shtetërore në përdorim, që janë:

i. numri, data dhe kodi unik (INDEX) i aplikimit;

ii. vendndodhja ose adresa e pasurisë, sipas aplikimit;

iii. tipi i ndërtesës që gjendet mbi truallin në përdorim dhe funksioni sipas evidentimit në terren;



iv. sipërfaqja e truallit në përdorim, sipas evidentimit në terren;

v. genplani dhe koordinatat e pasurisë, sipas evidentimit në terren;

vi. zona kadastrale, numri kadastral dhe kodi unik i kartelave të pasurive të paluajtshme, ku shtrihet trualli shtetëror në përdorim, sipas regjistrimit të pasurive të paluajtshme;

vii. gjendja juridike e pronësisë së pasurive, ku shtrihet trualli shtetëror në përdorim, sipas regjistrimit të pasurive të paluajtshme, para miratimit të dokumentit të pronësisë;

viii. vendimi përfundimtar për kalimin e pronësisë ose rrëzimin e kërkesës dhe shkaku i rrëzimit (nëse është rasti);

ix. numri, data, kohëzgjatja dhe shkaku, sipas aktit të pezullimit (nëse është rasti);

x. vlera e detyrimit financiar për kalimin e pronësisë së truallit dhe shlyerja e tij (nëse është rasti);

xi. të dhënat e vendimit të Këshillit të Ministrave për kompensimin e pronarëve joposodues, nëse është rasti;

xii. të dhënat e tjera të aplikimit, sipas formatit ose modelit të legjislacionit të kohës.

f) Të dhënat dytësore të bazës së të dhënave të proceseve kalimtare të pronësisë për secilin prej tyre, që janë:

i. numri personal i identifikimit (ID) i subjektit përfitues ose aplikues;

ii. gjenealogjia e subjektit përfitues ose aplikues;

iii. adresa ose vendbanimi i subjektit përfitues ose aplikues;

iv. çdo bazë tjetër të dhënash, që mund të ndërveprojë me bazën e të dhënave të proceseve kalimtare të pronësisë;

v. vendimet gjyqësore që kanë të bëjnë ose ndikojnë në procedurat administrative, sipas përcaktimeve të legjislacionit për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë.

II. ADMINISTRIMI DHE NDËRVEPRIMI ME BAZAT E TJERA TË TË DHËNAVE

8. Administrimi, mënyra e plotësimit dhe garantimi i sigurisë së të dhënave kryhen në përputhje me rregulloren që miratohet për bazën e të dhënave, sipas parashikimeve të shkronjës “c”, të pikës 4, të nenit 8, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”.

9. ASHK-ja përcakton ndërveprimin e bazës së të dhënave të proceseve kalimtare me baza të dhënash shtetërore të tjera për të dhënat parësore, në koordinim me Autoritetin Rregullator Koordinues të bazave të të dhënave dhe institucionet administruese.

10. Përdoruesit e bazës së të dhënave janë të përcaktuar në 4 nivele:

- a) lexues;
- b) redaktues;
- c) administrator;
- ç) auditues.

Funksionet dhe të drejtat e secilit përdorues janë në përputhje me pozicionin e punës dhe të përcaktuara në procedurat e punës, në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të ASHK-së, të miratuar nga Këshilli Drejtues për secilin nga punonjësit.

11. Lëshimi i ekstrakteve nga baza e të dhënave të proceseve kalimtare kryhet në bazë të tarifës përkatëse, të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi. Ekstrakti për ndërtimet pa leje është sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

12. Për ndërtimet pa leje, që nuk legalizohen, ekstrakti nga baza e të dhënave të proceseve kalimtare shërben për nisjen e procedurës administrative të trajtimit nga autoriteti përgjegjës për veprën ose projektin që përbën interes publik, sipas nenit 33, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”. Në këtë rast, subjekti, që zotëron ndërtimin pa leje që nuk legalizohet, nuk i nënshtrohet tarifës për lëshimin e ekstraktit të të dhënave.

13. Të gjitha ndryshimet në arkitekturën *software* dhe *hardware* të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, të cilat mund të ndodhin në varësi të nevojave të institucionit dhe zhvillimit të praktikave përkatëse, do të bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

14. Deri në ngritjen e bazës së të dhënave të proceseve kalimtare të pronësisë, ASHK-ja vijon të përdorë modulet ekzistuese për ruajtjen e të dhënave.

15. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe



ANEKSI 1

A-TË DHËNAT E APLIKIMIT
 Numri i aplikimit: _____; Data e Aplikimit: _____; Kodi unik (INDEX): _____
 Aplikuesi: _____; Nr. ID/ NIPT _____; E drejta e legalizimit i është njohur/kaluar: _____
 (emër, atësi, mbiemër) (emër, atësi, mbiemër)
 si përfitues i/të vetëm / bashkëpërfitues me aplikuesin, nëpërmjet aktit: _____
 (deklaratë noteriale, kontratë, dëshmi trashëgimie, vendim gjyqësor)
 Vendbanimi i aplikuesit: Bashkia _____ Rruga _____ Ndërtesa nr. _____ SH/K _____ Apartamenti nr. _____;
 Adresa e ndërtimit pa leje: Bashkia _____ Rruga _____ Ndërtesa nr. _____ SH/K _____ Apartamenti nr. _____;

B-TË DHËNAT E EVIDENTIMIT
 Lloji i ndërtimit _____ Funkzioni i ndërtimit _____; Në parcelën ndërtimore ka objekt ndihmës _____
 Sipërfaqja e ndërtimit: _____; Sipërfaqja e truallit: _____; Numri i kateve: _____; Sipërfaqja e parcelës ndërtimore _____ m²; Sipërfaqja e bazës (njollës) së objektit _____ m² Sipërfaqja shtesë që shfrytëzohet për banim _____ m²,
 ndarë në kate _____; për aktivitet social-ekonomik _____ m të ndarë në kate _____
 Koordinatat e ndërtimit pa leje _____
 *Për shtesat në ndërtime me leje: Funkzioni i hapësirave sipas faktit _____ m² (për secilin funksion)
 Sipas projektit të miratuar _____ (Sip. m² për secilin funksion)
 Përdorimi i shtesës: për nevojat vetjake të poseduesit ☐ për qeradhënie/shitblerje ☐

C-GJENDJA JURIDIKE
 Zona kadastrale _____ Numri i pasurisë/ve _____ Kodi Unik i kartelave të pasurisë _____
 Gjendja juridike e pasurisë _____
 E drejta e legalizimit i është njohur/kaluar: _____ si përfitues i/të vetëm / bashkëpërfitues me aplikues
 (emër, atësi, mbiemër)
 nëpërmjet aktit: _____
 (lloji i aktit: deklaratë noteriale, kontratë, dëshmi trashëgimie, vendim gjyqësor)
 Deklaratë për zgjedhjen e ndërtimit Nr. _____ Rep _____ Kol. Datë _____

D-TË DHËNAT E AKTIT PËRFUNDIMTAR (LEGALIZIMI, OSE MOSLEGALIZIMI)
 Data e genplanit _____ Data e planimetrisë _____
 Numri _____ data _____ e aktit të evidentimit në terren
 Urdhër nr. _____ datë _____ i përfshirjes/mospërfshirjes në fushën e zbatimit të ligjit
 Vendim nr. _____ datë _____ i legalizimit/ moslegalizimit; Shkaku i moslegalizimit _____

E-TË DHËNA TË TJERA
 Dokumenti i paregjistruar i fitimit të pronësisë _____
 Neni 25 i ligjit 20/2020
 Akt ekspertiza nr. _____ datë _____ për qëndrueshmërinë konstruktive të objektit për ndërtimet mbi 4 kate
 dhe për shtesën në ndërtim të regjistruar dhe për objektet me shkelje të lejes së ndërtimit;
 Urdhër nr. _____ datë _____ "Për pezullimin e procedurave të legalizimit"
 VKM nr. _____ Datë _____ "Për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi parcelat e objekteve të legalizuara"
 Vendim nr. _____ Datë _____ "Për kualifikimin e ndërtimit informal"
 Vlera e detyrimit financiar për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore _____ Lekë
 E shlyer ☐ E pashlyer ☐
 VKM nr. _____ Datë _____ "Për kompesimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, që preken prej tyre"

**VENDIM****Nr. 85, datë 10.2.2021****PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 597, DATË 4.9.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE, DOKUMENTACIONIT DHE MASËS MUJORE TË PËRFITIMIT TË NDIHMËS EKONOMIKE DHE PËRDORIMIT TË FONDIT SHITESË MBI FONDIN E KUSHTËZUAR PËR NDIHMËN EKONOMIKE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 8, të nenit 12, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”; të pikës 5, të nenit 41, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, dhe të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 14, të kreut III, të vendimit nr. 597, datë 4.9.2019, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 15, me këtë përmbajtje:

“15. Për përfituesit e ndihmës ekonomike, të përcaktuar në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d”, të pikës 2, të kreut I, të këtij vendimi, masa e ndihmës ekonomike dyfishohet për një periudhë 6-mujore, me qëllim zbutjen e efekteve të shkaktuara nga epidemia COVID-19.”.

2. Ngarkohen të gjitha organet e administratës shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2021.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



Anekset që duhet t'i ishin bashkëlidhur vendimit nr. 1178, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e dokumentacionit dhe të rregullave të hollësishme të evidentimit të ndërtimeve pa leje", botuar në Fletoren Zyrtare nr. 22, datë 11 shkurt 2021.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENSIA SHTETËRORE E KADASTRES
DREJTORIA []

AKT EVIDENTIMI
Nr. [], datë []

PËR GJENDJEN NDËRTIMORE NË TERREN, TË NDËRTIMIT PA LEJE

Në zbatim të nenit 17, pika 3 dhe 69, pika 9, të ligjit 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.... "Për përcaktimin e dokumentacionit dhe rregullave të hollësishme të evidentimit të ndërtimeve pa leje" u krye evidentimi në terren i ndërtimit pa leje i llojit: ☐ Objekt, ☐ Shtesë, ☐ Objekt me shkelje të lejes së ndërtimit përfshirë në procedurat e legalizimit nëpërmjet aplikimit N[] prot., datë [] me Numër Unik (INDEX): me adresë

Nga evidentimi në terren rezultojnë se ndërtimi pa leje posedohet nga:

1. _____ Nr. identifikimi _____ (ID): _____, Nr. cel: _____,

Adresa: _____

(Emër, Adresë, Mbiemër)

2. _____ Nr. identifikimi _____ (ID): _____, Nr. cel: _____,

Adresa: _____

(Emër, Adresë, Mbiemër)

...
Ndërtimi pa leje me funksion _____ ka këto të dhëna ndërtimore:

- Sipërfaqja e bazës (njollës) së objektit _____ m²

- Numri i kateve mbi tokë _____ dhe nën tokë _____

- Sipërfaqja e përgjithshme e ndarë sipas funksionit: banim _____ (Sip. m²), aktivitet social-ekonomik _____ (Sip. m²)

- Sipërfaqja e parcelës ndërtimore _____ m² me objekt ndihmës ☐ pa objekt ndihmës ☐

*E aplikueshme vetëm për shtesën, objektin me shkelje të lejes së ndërtimit:

- Aplikuesi për legalizim është shoqëri ndërtuese dhe/ose investitor ☐

- Shtesa është kryer për qëllim kalimi pronësie ose qiradhënie ☐

- Funksioni i hapësirave sipas faktit: _____
(Sip. m² për secilin funksion)

- Funksioni i hapësirave sipas projektit të miratuar _____
(Sip. m² për secilin funksion)

Pasuritë kufitare (nr. pasurisë, emër, mbiemër i pronarit të objektit kufitar, lloji i pasurisë psh. objekt, rrugë/kanal etj):

Në veri: _____

Në jug: _____

Në perëndim: _____

Në lindje: _____

Evidentimi në terren u krye nga:

Specialisti i ASHK/Përfaqësuesi i subjektit: 1. _____ 2. _____
(emër, mbiemër, firmë) (emër, mbiemër, firmë)

Konfirmoi për strukturën e Hartografisë të ASHK-Përgjegjësjë: _____
(emër, mbiemër, firmë)

1-Ky akt plotësohet elektronikisht dhe pas nënshkrimit ruhet në 2 kopje, respektivisht një administrohet në praktikën e legalizimit dhe tjetra ruhet në përputhje me legjislacionin për arkivat.

2-Kopja e Aktit të evidentimit shoqërohet detyruesisht me skicë fushore.

3-Sipërfaqet që evidentohen në akt do të plotësohen me shifra dhe fjalë.

4-Verifikimi në terren kryhet nga jo më pak se dy specialistë të ASHK, ose punonjës të subjektit të kontraktuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
KËRKESË
PËR LEGALIZIM TË NDËRTIMIT PA LEJE

Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni: Tel: E-mail: Cë:	HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN Drejtoria/Zyra Vendore e ASHK _____
--	---

SEKSIONI A: INFORMACION MBI APLIKANTIN/ËT

1. Emër, Atësi Mbiemër: _____
 Nr. identifikimi (ID): _____, Nr. cel: _____, Adresa: _____
 2...

OSE

Përfaqësuesi i autorizuar me prokurën nr. _____, datë _____:
 1. Emër, Atësi, Mbiemër: _____
 Nr. identifikimi (ID): _____, Nr. cel: _____
 Adresa: _____

SEKSIONI B: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKIMIN

Në mbështetje të nenit 17, të ligjit nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" dhe në zbatim të Vendimit nr. _____, datë _____ të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e dokumentacionit dhe rregullave të hollësishme të evidentimit të ndërtimeve pa leje", kërkoj/më legalizimin e ndërtimit pa leje të llojit:

☐ Objekt, ☐ Shtesë, ☐ Objekt me shkelje të lejes së ndërtimit me adresë: _____
Rruga, Njësia e vetqeverisjes vendore

SEKSIONI C: DOKUMENTACIONI I PARAQITUR

Kërkesa shoqërohet (opsionale) nga:
 Dokumentacioni i pronësisë mbi truallin: _____
 Dokumentacion shoqërues: _____

SEKSIONI Ç: PAGESA

Tarifë aplikimi për legalizim ndërtimi pa leje: 3 000 (tremijë) Lekë
 Institucioni përfitues: Emërtimi _____ Kodi _____ Nr. llogarisë _____ IBAN _____

|



2204966716291

ASHK i bashkëlidh kërkesës, certifikatën e gjendjes familjare të momentit të aplikimit, të kërkuarit.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 96 lekë